
AKT THEMELIMI
"International eye clinic" SHPK

1. Forma ligjore, emri i shoqërisë dhe ortakut themelues

Emri i shoqërisë do të jetë **"International eye clinic" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".


Shoqëria zotërohet nga ortakut i vetëm:

- **Z.Robert Mello**, atësia Pandeli, amësia Marianthi, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga: "Don Bosko"; Nd. 49; H. 6; Ap. 23, lindur më 20/02/1959, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID Nr. 036942598 dhe Nr. Personal F90220110S.

1. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Shërbime mjekësore në fushën e okulistikës, diagnostikime të plota të semundjeve të syrit, trajtime terapeutike dhe kirurgjikale, ekzaminime oftalmologjike, trajtime me laser.
- Kryerjen e konsultave oftalmologjike, diagnostikime të patologjive oftalmike ku përfshihen: patologjite korneale dhe glaucoma, patologjite retinale dhe neurooftalmologjia, patologji të oftalmologjise pediatrike dhe okuloplastika.
- Ekzaminime dhe trajtimi i anomalive rekraktive, korrigjim me syze, lente kontakti (te buta ose rigide), injeksione intravitreale, dhe injeksione peri/retrobulbare, perdorimi i Cross-Link (CXL).
- Do te kryhen ekzaminime imazherike si: autorefraktometria dhe biomikroskopia, topografia korneale, microperimetria, tomografia retinale, Eko A/B dhe Angiografia me Fluoresceine. Do te kryhen nderhyrje kirurgjikale me anestezi topikale per trajtimin e kataraktes, pterygiumit dhe chalasion ose me anestezi gjenerale per trajtimin e obstrukcioneve te duktusit nazolakrimal.
- Import/eksport te pajisjeve mjekesore, medikamenteve, skeleteve te syzeve, si edhe te gjitha materialeve apo pajisjeve qe lidhen me zhvillimin dhe permbushjen e veprimtarise se saj.
- Shitje -blerje me shumice dhe pakice të pajisjeve mjeksore, medikamente , syze optike, skelete dhe xhama syzesh të llojeve të ndryshme.



Pa u kufizuar në sa më sipër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të lejuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

2. Selia e shoqërisë.

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën:

- **Rruga: "Shyqyri Berxolli" , pallati 31, shkalla 3,ap 1, Tiranë.**

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

3. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

4. Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100 000** (njëqind mijë lekë).


Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlere nominale **ALL 100 000** (njëqind mijë lekë) dhe zotërohen nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

5. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

6. Administratori.



Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është:

- **Z.Robert Mello**, atësia Pandeli, amësia Marianthi, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga: "Don Bosko" ; Nd. 49; H. 6; Ap. 23, lindur më 20/02/1959, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID Nr. 036942598 dhe Nr. Personal F90220110S.

7. Likuidimi i shoqërisë.

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Z. Robert Mello



[emër mbiemër dhe nënshkrimi]

Datë 03.02.2025